



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2023:063239

Datë: 31.01.2024

Numri i dokumentit: 05269311

P.nr. 21/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Sabaheta Kurteshi, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Senida Nuri, në lëndën penale kundër të pandehurit ndaj të pandehurit D. J. nga fsh..., me numër personal..., për shkak se ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 parag. 1 dhe veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria-Prokuroria Themelore Prizren - Departamenti i përgjithshëm nr. P.nr.152/22 , të datës 10.03.2023 në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 29.12.2023 , pa praninë e Prokurorit të Shtetit, ne prezencë të pandehurit D. J., mbrojtësit të tij av. A. R. nga Dragashi, më datë 29.12.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 31.01.2023 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj te Akuzuarit:

D. J., i lindur më dt..., me numër personal..., i biri i M. J. dhe nënës Dž. J., e gjinisë M., me vendbanim në fsh..., Komuna e Dragashit, ka të kryer shkollën fillore, me profesion kamerier, i martuar, babë i një fëmije, goranë, Shtetas i Republikës së Serbisë.

ËSHTË FAJTOR

1.Sepse ka mbajtur në pronësi armën në kundërshtim në Ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, në atë mënyrë që nga data e pa vërtetuar e deri me dt. 01.08.2022 rreth orës 23:55 min. në fshatin..., Komuna e Dragashit gjatë një ahengu familjar, në brez ka pasur të fshehur pistoletën me gazë “Gap Kal 9 mm PAK me nr. serik 2020NO....” së bashku me një karikator të pistoletës, pa lejen e Organit kompetent.

Këso dore ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës Kodi nr. 06/L-074.

Dhe

2.Me anë të armës shkakton rrezik të madhe për jetën e njerëzve, ashtu që me dt. 01.08.2022 rreth orës 23:55 min. gjatë një ahengu familjar të organizuar në fshatin Orqushë, Komuna e Dragashit, në prezencë të shumë mysafirëve nxjerrë nga brezi nxjerrë pistoletën me gazë “Gap Kal 9 mm PAK me nr. serik 2020NO83396” dhe shkrep pesë herë.

Këso dore ka kryer veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës Kodi nr. 06/L-074.

Andaj gjykata në mbështetje të nenit 2, 4, 7, 8, 17, 38, 39, par. 1 nën par. 1.1, neni 40 par. 1 nën par. 1.2 dhe 1.3, neni 42, 43 neni 69, 70, 71, 72 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK), si dhe neni 364 Kodit të procedurës penale Kodi nr. 08/L-032 e gjykon me :

Për veprën penale si nën I/. të diapozitivit të pandehurit i shqiptohet:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 2.000,00 (dy mijë euro) €, të cilin dënim do ta paguaj përmes llogarisë rrjedhëse të kësaj gjykate nga dita e plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimit.

Dhe për veprën penale si nën II/. të diapozitivit të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME BURG

Për veprën penale si në dispozitiv nën II/. të këtij Aktgjykimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve të cilin dënim do ta vuaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimit.

Pas shpalljes së Aktgjykimit i pandehuri Danijel Jahiq dhe mbrojtësi i tij me autorizim av. A. R. i propozojnë gjykatës që dënimi me burg ti shqiptohet me dënim me gjobë.

Gjykata konform nenit 44 par. 1 dhe 2 e më pëlqim të pandehurit dënimin me burg i zëvendësohet më:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 1.500,00 (një mijë e pesëqindtë euro) €, të cilin dënim do ta paguaj përmes llogarisë rrjedhëse të kësaj gjykate, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimit.

Konform nenit 76 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK), gjykata të pandehurit i shqipton:

DËNIM UNIK

Me dënim me gjobë për dy veprat penale dhe atë veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës Kodi nr. 06/L-074 dhe për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës Kodi nr. 06/L-074, gjithsejtë në shumë prej 2.400,00 (dy mijë e katërqindën €, të cilin dënim do ta paguaj në llogarinë rrjedhëse të kësaj gjykatë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimit.

Po qe se dënimin me gjobë i pandehuri nuk e paguan në afatin e caktuar i njëjti dënim si më lart me këtë Aktgjykim zëvendësohet me dënim me burgim dhe atë prej 4 muajve, duke llogaritur 20 € në një ditë burgu nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Në kuptim të nenit 269 të KPP-së, lidhur me nenin 270 par.1 të KPP-së i shqiptohet dhe :

DENIMI PLOTESUES

Pistoletën me gazë “Gap Kal 9 mm PAK me nr. serik 2020NO8.....” së bashku me një karikator të pistoletës.

OBLIGOHET i akuzuari që të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato të bëhen në bazë të llogarisë, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50,00 €(pesëdhjete euro) dhe taksës për kompensimin e Viktimave të Krimin, shumën prej 20,00 € (njëzetë euro), në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimit.

A r s y e t i m

Historiku procedurës dhe aktakuza

Prokuroria themelore ne Prizren pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë kundër të pandehurit D. J. nga fsh..., me numër personal..., për shkak se ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 parag. 1 dhe veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK). me propozim qe gjykata pas administrimit te provave të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënim të paraparë me ligj.

Gjykata ka aplikuar dispozitat e Kodit te procedurës penale Kodi nr. 08/L-032 me rastin e marrjes dhe shpalljes se aktgjykimit dhe lidhur me dispozitat e te njëjtit kod ka vepruar tek forma e aktgjykimit.

Gjyqtarja e çështjes ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë 28. 12 2023, në prezencën të pandehurit dhe mbrojtësit av. A. R. nga Dragashi , e në mungesë Prokurorit te Shtetit dhe të dëmtuarit edhe pse të njëjtit kanë qenë të thirrur në mënyrë të rregullt por mungesën e tij nuk e ka arsyetuar .

Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi ka udhëzuar të pandehurin në bazë të nenit 241 par.1 të KPPK-ës dhe pasi prokurori i shtetit ka lexuar aktin akuzues dhe pasi gjyqtarja u bind se i njëjti e ka kuptuar aktakuzës, në bazë të nenit 241 par. 4 si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve 242 të KPPK-ës , te njëjtit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

Pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit:

I pandehuri deklaron: se e ndien vetën fajtor për këtë veprë penale – pranoj fajësinë për veprën penale me të cilin ngarkohem.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. A. R. deklaron: në kuptim të mbrojtjes i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit dhe caktimit të lartësisë së dënimit të ketë parasysh mënyrën dhe rrethanat lehtësuese në të cilat i mbrojturi im ka kryer veprat që i ngarkohet, i njëjti veprimet e përshkruara në aktakuzë i ka ndërmarrë duke mos qenë i vetëdijshëm se këto veprime janë ndaluar dhe bëjnë veprën penale, nuk ka pasur qëllim të shkaktoj rrezik apo të dëmtoj dikën, armë me të cilën është kryer vepra penale si në aktakuzë është pistoletë e gazit, e njëjtat nuk është armë reale. Gjithashtu rrethana tjera lehtësuese, faktin se i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, është kryefamiljar, nuk ka një punë të rregullt punon në ndërtimtari përkohësisht – gjatë sezone, asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me Ligjin, në çdo fazë të kësaj procedure ka qenë bashkëpunues me organet e drejtësisë si dhe i njëjti ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare duke premtuar se në të ardhmen do të jetë i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga çdo veprimi i kësaj natyre dhe natyrave tjera.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 241 par.4 të KPPK-ës, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit Përfaqësuesi i akuzës - prokurori i shtetit, me rastin e paraqitjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, dhe pas pranimin të fajësisë, Prokurori i shtetit ka deklaruar: - ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe mbetet në tërësi pranë Aktakuzës.

I pandehuri dhe mbrojtësi av. A. R. me datën 29.12.2023 me rastin e shpalljes së aktgjykimit dhe pas komunikimit të dënimit me burg kanë deklaruar : i propozoj gjykatës që dënimin me burgim të shndërrohet në dënim gjobë për veprën penale veprën shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK),

Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së si dhe me këtë rast vlerësoi - se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, - pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret si dhe materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, si dhe ne provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: kallëzimi penal me numër rasti 2022- GD-143 dhe raporti i oficerit i datës 18.08. 2022, deklarata e të pandehurit të dhënë në Stacionin Policor në Dragash, listës së dëshmive të armës së konfiskuar bashkë me fishekët si dhe listës së dëshmive bashkë me fotografi - aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja në bazë të nenit 242 par.6 lidhur me para 2 të KPP-ës, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. Gjykata po ashtu vërtetoi se prokurori ka disponuar me prova të mjaftueshme për veprën penale të pandehurit dhe ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e tij.

Analiza e ligjit material

Por, gjykata vlerëson se në rastin objekt gjykimi, provohet përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka pasi që u vërtetua se tek i njëjti ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale duke **vërtetuar këtë gjendje faktike**: Sepse ka mbajtur në pronësi armën në kundërshtim në Ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, në atë mënyrë që nga data e pa vërtetuar e deri me dt. 01.08.2022 rreth orës 23:55 min. në fshatin..., Komuna e Dragashit gjatë një ahengu familjar, në brez ka pasur të fshehur pistoletën me gazë “Gap Kal 9 mm PAK me nr. serik 2020NO8...” së bashku me një karikator të pistoletës, pa lejen e Organit kompetent, ku me këto veprime ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës Kodi nr. 06/L-074,Dhe

Me anë të armës shkakton rrezik të madhe për jetën e njerëzve, ashtu që me dt. 01.08.2022 rreth orës 23:55 min. gjatë një ahengu familjar të organizuar në fshatin..., Komuna e Dragashit, në prezencë të shumë mysafirëve nxjerrë nga brezi nxjerrë pistoletën me gazë “Gap Kal 9 mm PAK me nr. serik 2020NO.....” dhe shkrep pesë herë, ku me këto veprime ka kryer veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës Kodi nr. 06/L-074.(KPRK).

Me qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkuara më lartë, gjyqtari në bazë të nenit 242 paragrafit 6 lidhur me para.2 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. Gjykata po ashtu vërtetoi se prokurori ka disponuar me prova të mjaftueshme për veprat penale të akuzuarit dhe ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e tij. Gjykata vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprave penale dhe atë vepra penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 dhe veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK).

Nga interpretimi dispozitës të nenin 185 arrihet në përfundimin se: ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe integritetit fizik të personave që kanë që prezent në rastin e gëzimit familjar, frika për mundësin e shkaktit të dëmit etj, cenimi i të cilit pas sjell përgjegjësi penale. Këto veprime, për t’u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që të kenë rrezikuar shëndetin e personave me përdorimin e armës dhe gjuajtje duke shkakuar rrezik të përgjithshëm, Në rastin konkret veprimet e dhunës fizike të ndërmarra nga i akuzuari janë përdorimi i pushkës , gjuajtja me të në gëzimin familjar me qrast me këto veprime cenuar integritetin e personave prezent duke shkakuar frik për jetë dhe ka shkakuar dhe rrezik të përgjithshëm, rrethana këto cilësuese të veprave penale ,ashtu që cenimi të këtyre të drejtave sjellë përgjegjësi penale.

Caktimi i dënimit për të pandehurin Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70,71,72 të KPRK-ës , andaj në rastin konkret vlerëson se janë përmbushur kushtet e parapara në dispozitat e lartë cekura si dhe duke zbatuar dispozitat të KPRK-ës të pandehurin e gjykoj me dënim unik me gjobë prej 2.400,00 (dy mijë e katërqindën) €, e i cili dënim është ë në përputhje më shkallën e përgjegjësisë penale, peshën e veprës, për faktin se veprat penale kanë të bëjnë me mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 dhe veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm. Si rrethanë veçanërisht lehtësuese vlerësoi pranimin e fajësisë për veprën penale të kryer, e cila është bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin e tij për këto vepra penale, ndërsa sa i për ketë rrethanave veçanërisht

rënduese gjyqtarja e vetme gjykuese vlerësoi shkallën e përgjegjesisë penale të pandehurit se kryesi veprën e ka kryer me dashje si dhe rrezikshmërinë e përgjithshme të veprave penale, si dhe me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi intensitetin e rrezikimit apo i dëmtimit të së mirës së mbrojtur- cenimi i dinjitetit te personave – qytetarëve në gëzimin familjar në këtë raste etj.. Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprave penale dhe përgjegjësinë penale të pandehurit, andaj të njëjtit i shqiptoi dënimet ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit përkatësisht dënimi i shqiptuar do të shërbej në parandalimin të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penal.

Vendimin për dënim plotësues dhe atë konfiskimi i Pistoletës me gazë “Gap Kal 9 mm PAK me nr. serik 2020N.....” së bashku me një karikator të pistoletës. Gjykata vendosi në kuptim të nenit 269 të KPPRK-së, lidhur me nenin 270 par.1 të KPPRK-së

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u murrën në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 450 të KPPK-së, ndërsa për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Në bazë të theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 te Kodit te procedurës penale Kodi nr. 08/L-032.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2023:063239, 29.12.2023

G j y q t a r i

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.